

VENDIM
“PËR VENDOSJE SEKUESTRO PREVENTIVE”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga :

GJYQTARE: BLERINA MUÇA

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Evanthi Bala, në Tiranë, date 07.07.2011, shqyrtoi kërkesën që i përket:

KËRKUES: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Tiranë përfaqësuar nga prokurorja Daniela Sulaj.

OBJEKTI : Vendosje e sekuestros preventive per procedimin penal nr. 4155 viti 2010.

BAZA LIGJORE : Neni 36 i Kodit Penal dhe neni 274 pika 2 i Kodit te Procedures Penale.

Gjykata, pasi dëgjoji prokuroren që kërkoi pranimin e kërkesës, shqyrtoi materialin procedues,

VËREN

Nepermjet kerkeses se Prokurorise se Rrethit Tirane, depozituar ne Gjykate ne daten 07.07.2011, kerkohet te vendoset sekuestro preventive mbi disa pasuri te luajtshme, ne pronesi te shoqerive “Fisheku” sha dhe “Martini Petrol” shpk, me ortak dhe administrator personin nen hetim (.....).

Nga aktet shoqeruese te kerkeses rezulton sa me poshte:

Ne date 13.10.2010, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane ka regjistruar procedimin penal Nr. 4155, per vepren penale te “Pastrimit te produkteve te vepres penale”, “Kontrabandes me mallra qe paguhen akcize” “Mashttrimit” dhe “Shperdorimit te Detyres”, vepra penale keto te parashikuara nga nenet 287, 172, 143/2 dhe 248 te Kodit Penal.

Gjate fazes se hetimeve, mbi kerkesen e Prokurorise se Rrethit Gjyqësor Tirane, nepermjet Vendimit Nr. 408 date 06.03.2011, kjo gjykate ka vendosur te caktoje masen e sigurimit personal “Arrest ne Burg” per te dyshuarin (.....), dyshuar per veprat penale te

“Mashtrimit”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal dhe “Pastrimi i produkteve te naftes”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Nga provat e administruara gjate hetimeve te metejshme, konkretisht shkresa me nr. 2958/1 prot. date 09.05.2011 e Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor Tirane, rezulton qe ne pronesi te shoqerise “**Fisheku**” sha, te figurojne te regjistruara mjetet si me poshte:

- (.....)
- (.....)
- (.....)
- (.....)

ndersa ne pronesi te shoqerise “**Martini Petrol**” shpk, figurojne te regjistruara mjetet si me poshte:

- (.....)
- (.....)
- (.....)
- (.....)
- (.....)
- (.....)
- (.....)

Nga te dhenat e pasqyruara ne ekstraktet e dy shoqerive te mesiperme, nxjerre nga Qendra Kombatre e Regjistrimit, rezulton qe per shoqerine “Fisheku” sha, aksioner i vetem eshte personi nen hetim (.....) dhe per shoqerine “Martini Petrol” shpk, ky shtetas rezulton ortak dhe administrator i (.....)

Neni 274 pika 2 i Kodit te Procedures Penale, parashikon rastet e vendosjes se sekuestros preventive mbi pasurite qe mund te lejohen te konfiskohen, sipas percaktimeve te nenit 36 te Kodit Penal. Kjo dispozite penale, mes te tjerash ne piken 1.ç te saj, parashikon si sende te konfiskueshme *çdo pasuri tjeter, vlera e se ciles korrespondon me ate te produkteve te vepres penale.*

Nisur nga sa me lart, ne rastin konkret ekziston rreziku qe pasurite ne emer te shoqerise “Fisheku” sha dhe “Martini Petrol” shpk, te mund te tjetersohen. Per rrjedhoje, gjykata, ne perfundim te shqyrtimit te kerkeses arrin ne perfundimin se plotesohen kushtet dhe kriteret ligjore te percaktuara ne nenet 274/2 te Kodit te Procedures Civile dhe 36 pika 1.ç te Kodit Penal, per vendosjen e sekuestros preventive mbi automjetet e regjistruara ne DPSHTRr Tirane ne emer te ketyre dy shoqerive ne pronesi te personit nen hetim (.....).

PËR KËTO ARSYE

Konform nenit 274/2 te K.Pr.Penale dhe nenit 36 te Kodit Penal

VENDOSI

- Pranimin e kërkeses se Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane.
- Vendosjen e sekuestros preventive mbi pasurite e luajtshme “automjete” te regjistruara ne emer te shoqerise “Fisheku” sha dhe “Martini Petrol” shpk, prane DPSHTRr Tirane si me poshte:

– (.....)
– (.....)
– (.....)
– (.....)

– (.....)
– (.....)
– (.....)
– (.....)
– (.....)
– (.....)
– (.....)

Ngarkohen Oficeret e Policise Gjyqesore te Drejtorise Kunder Krimin Financiar ne Drejtorine e Pergjithshme te Policise se Shtetit.

- Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit ne Gjykatën e Apelit Tirane.

Tiranë, me 07.07.2011

SEKRETARE

GJYQTARE

EVANTHI BALA

BLERINA MUÇA